



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Datë: 28/02/2025

Ref: 223/2025

E nderuara familja Bujari,

Ngushëllimet më të ndjera e të thella në emër timin dhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës për humbjen e njeriut tuaj më të afërt.

Albanin do ta mbajmë mend përherë e do ta kujtojmë për rolin e tij si fotoreporter veçanërisht në dokumentimin e masakrave të luftës së fundit në Kosovë, ku pamjet shërbejnë si dëshmi që ndërgjegjësojnë më tej edhe opinionin e mediat ndërkombëtare. Me kurajën e njëjtë e kureshtjen e pashtershme përcolli zhvillimet shoqërore e politike edhe pas luftës. Syri i tij na ka përcjellë për afër tri dekada, e unë fytirën e tij e kam parë në pothuajse çdo aksion politik si opozitar e aktivitet publik tash si kryeministër. Jemi takuar shpesh, por jo aq sa duhej për kohën e gjatë që njiheshim. Do të na mungojë gjithmonë, mungesa e tij do të vërehet përherë.

Por, ai do të jetojë përmes veprave të tij, e nga to do ta mbajë të gjallë dhe kujtimin për viktimat e luftës së fundit, masakrat e shtypjet sistematike të viteve të '90-ta.

Fotografitë e Albanit janë e do të jenë gjithmonë kujtesa jonë për dhimbjet e popullit tonë dhe përkujtimi i çmimit për lirinë që e gëzojmë sot. Me punën e tij, ai trashëgoi vetëdije historike e kombëtare.

Albani fotografoi që kurrë mos të harrojmë, e prej sot fotografitë e tij do të kujdesen që ne kurrë mos ta harrojmë Albanin.

Me respekt,

Albin Kurti

Kryeministër i Republikës së Kosovës